



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Agj. Org. Org. Jeshit Org. Unit	AQP
No. / Pageve Br. Stranica No. Pages	1/34
No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	45/18
Data : Datum : Date :	25.05.2018
Prishtine / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agjencia Nabavke-Central Procurement Agency

KONTRATË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:
KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË PËR SHËRBIME TË PASTRIMIT

LOT 1

NUMRI I PROKURIMIT: AQP/15/011/211

PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË¹, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Agjencia Qendrore e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues" i cili prokuron në emër të vet dhe në emër të Autoriteteve Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7"), në njërën anë;

dhe

Beni & Euroing Rr.Nëna brigada 123 Suharek (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Titulli i kontratës: SHËRBIME TË PASTRIMIT me numër identifikues: AQP/15/011/211

Nr. rendor i kontratës 003/2018-DPQ - LOT I

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve të pastrimit nga Ofruesi i Shërbimeve siç është përcaktuar në Dosjen e tenderit për:

1.2

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Data e skadimit të kontratës tuaj	Çmimi
1.	Agjencia statistikore e Kosovës & Ministria e Diasporës	30/10/2020 (8 muaj)	1,579,025
2.	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	10.05.2019 (25 muaj)	253
3.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Shoqëror	01.07.2018 (35 muaj)	12,974.56
4.	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	18.12.2018 (27 muaj)	2,2207.5
		Totali në muaj	16,983.09

AQP kryen blerje në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese të përcaktuara në aneksin 7. Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjëherë prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund

¹ Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1. Për me tepër disa Autoritete Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7 kanë kontratat e tyre ekzistuese. Këto kontrata nuk do të ndërpriten, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy jave para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftoj me shkrim AQP-ne dhe Ofruesin e Shërbimeve lidhur me datën e skadimit e të kontratës dhe datën e fillimit të shfrytëzimit të kontratës kornizë.

1.4 Nënshkrimi i kontratës publike kornizë nuk imponon obligim mbi asnjërin Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7 për të blerë sasi të parapara në Aneksin 1. Ofruesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoritetet kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 vendosin të blejnë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoritetet kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 vendosin të MOS blejnë ASNJE nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Zbatimi i kësaj kontrate kornizë do të fillojë me nënshkrim nga të dyja palët. Kjo kontratë kornizë ka kohëzgjatje prej tridhjetë e gjashtë (36) muajve.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Zbatimi i kontratës kornizë do të kryhet vetëm me ane të "urdhër blerjeve" dhe data e implementimit do të fillojë në datën e pranimit të "urdhër blerjes" nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

2.2 Vendi i performimit të shërbimeve do të jetë: në objektet e Autoriteteve Kontraktuese.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoritetet Kontraktuese të përcaktuara në Aneksin 7 do të kenë borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet cilitdo Autoritet Kontraktues të specifikuar në Aneksin 7, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]² në tri origjinale, dy origjinale për AQP-ne dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve. Një kopje e nënshkruar e kontratës do të dorëzohet secilit Autoritet kontraktues të specifikuar në Aneksin 7 nga Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe është në fuqi nga data **01.06.2018**.


5.5 Kontrata nënshkruhet pas vendimeve të OSHP-së dhe Urdhërësive të OSHP-së që janë pjesë e kësaj kontrate.

Për Agjencinë Qendrore të Prokurimit

Emri:	Ekrem Rexha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	25.05.2018
Vula:	
Emri:	Behxhet Rruqi
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	25.05.2018
Data:	
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Arben Juci
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	25.05.2018
Vula:	



¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë cilido Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7.

1.3 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.4 **"Agjencia Qendrore e prokurimit"** do të thotë organizata e cila konkludon aktivitetin e prokurimit në emër të vet dhe në emër të Autoriteteve të tjera Kontraktuese, siç është përcaktuar në Fletën e të Dhënave.

1.5 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.6 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.7 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.8 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.9 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.10 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Detyrimet

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të menjauar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep diku kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur, punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikatat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhrat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrersë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti bëhen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet,

pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne dhe AQP do të merr të gritis hapat ligjor sipas kësaj kontrate.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19. Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njera tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj palë të tretë.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Transferimi	3	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	7	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.

Ndërprerja e Kontratës nga AK	9	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve	10	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11.1	Ofruesi i Shërbimeve do të kryej të gjitha shërbimet me cilësi të lartë.
	11.2	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
	11.5 & 11.6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.1	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
	12.3	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7. Çdo AK do të ofrojë ofruesit të shërbimeve detajet e Menaxherit të Projektit. Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 5 (pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe ofruesit të shërbimeve i cili do të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Dëmet e Likuiduara	13	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Ofruesi i shërbimeve, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës për secilin Lot.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Ofruesi i Shërbimeve do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do të sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Menaxherin e Projektit kundër, çdo kërkesë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ofruesi i shërbimit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tij.
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga secili Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7 në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake.

		Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Ofruesi i Shërbimeve duhet të dorëzoj tek secili AK i specifikuar e Aneksin 7 një faturë origjinale dhe një kopje për shërbimet e kryera gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	n/a
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyre miqësore , përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jene personat përgjegjës te Autoritetit Kontraktues – AQP-se , dhe zyrtaret përgjegjës te Autoriteteve Kontraktuese qe shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës te ofruesit të shërbimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh te Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e zbatueshme në Kosovë.

PJESA C: FORMULARI I DORËZIMIT TË TENDERIT- të gjitha kushtet e përcaktuara³

Pjesa I. Formulari i TENDERIT

Për: Agjencia Qendrore e Prokurimit : Rruga Nena Terezë p/n, Ndërtesa e Gërmisë, (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: Shërbime te pastrimit

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit më poshtë, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Nr **AQP/15/010/211**.

Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

[Lot 1 – Shërbime te pastrimit – Ndërtesa e Agjencisë Statistikore te Kosovë, Ministria e Diaspores, ARH, MPMS dhe SKGJK]

[Lot 2 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e Arkives se Kosovës, Agjencionit Kadastral, AKPM, IGJK, KPMM dhe MTI]

[Lot 3 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e Rilindjes, ARKEP, GJKK dhe KPM]

[Lot 4 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e Gërmisë, ATK, PZSHAP dhe SKQZH]

[Lot 5 – Shërbime te pastrimit – Ndërtesa e MASHT I , MASHT II dhe ASHAK dhe Ndërtesa e Partive Politike]

[Lot 6 – Shërbime te pastrimit – Ndërtesa e Qeverise & Ndërtesa e MFSK-se & AUV]

[Lot 7 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e MPJ-se dhe ASHMDHP-se & AKSP]

[Lot 8 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e MPB & MSH & Prokuroria]

[Lot 9 – Shërbime te pastrimit - Policia e Kosoves

[Lot 10 – Shërbime te pastrimit - Ndërtesa e Pallatit te Drejtësisë]


[Lot 11 – Shërbime te pastrimit – Universitetet, ZAG dhe ZRE]

[Preferenca jone per Lotet e dorezuara është si më poshte:
shëno numrin e Lotit dhe përshkrimin
shëno numrin e Lotit tjetër dhe përshkrimin ...]

3. Çmimi i përgjithshëm i tenderit është:

³ Aplikohet kur të gjitha kushtet janë përcaktuar (nuk ka mini-konkurrencë)

DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – HAPUR/Shërbim–një OE



1. *[Signature]*
2. *[Signature]*
3. *[Signature]*

Lot 1: [16,983.085	mi/ysiste'/neste'/lete'/hep/zer/lete'/zer	- Lot-1
Lot 2: [8,861.57	lete'/lete'/ysiste'/i/zer/stele'	- Lot-2
Lot 3: [15,154.16	yi/zer/zi/ysiste'/lete'/i/ysite'/ysite'	- Lot-4
Lot 5: [12,230.48	yi/ysite'/ysite'/zer/lete'/lete'	- Lot-5
Lot 6: [19,094.16	mi/neste'/zer/ste/lete'/lete'/ysite'	- Lot-6
Lot 7: [16,326.47	yi/ysite'/neste'/ysite'/lete'/ste/ste'	- Lot-7
Lot 8: [12,835.00	yi/ysite'/lete'/hep/zer/zer/zer	- Lot-11

4. Ky tender është valid për një periudhë prej **120 ditëve** nga data finale për dorëzim të tenderëve

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë, siç kërkohet, një siguri të ekvivalente të para nënshkrimit të kontratë në vlerë prej 10% (secili Lot) për kohëzgjatjen prej 36 muajve.

6. Operatori Ekonomik [dhe nën-kontraktuesit tonë] ka/kanë nacionalitetin siç vijon: [shqiptarë]

7. Ne jemi duke e bërë këtë aplikim, për këtë tender [shëno numrin e pjesëve, nëse aplikohet], në të drejtën tonë të udhëhequr nga vetja. Ne konfirmojmë se ne nuk jemi duke tenderuar për kontratën e kësaj në ndonjë formë tjetër.

[Në rast të një konsorciumi]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e pjesëve, nëse aplikohet] **sipartner në konsorcium**, të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formë tjetër. Ne konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].


8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim , mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

1. Wally
2. Bunky
3. chunky



DORËZUAR NGA


IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	N.P.T BENI
ADRESA E PLOTE	SUHAREKE
PËRFAQESUAR NGA:	
EMRI	ARBRN KUQI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	28.05.2016
VULA	

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik:]

	Emri(at)	Adresa-banimit
Udhëheqësi 1*	EURO-ING SH.P.K	SUHAREKË
Etj ... *		

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesit nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.



Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsortiumit:
[shëno emrin dhe mbiemrin] **A RBRN KUQI**

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar] 


Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën] **25.05.2016; SUHAREKË**

Vula e Udhëheqësit:



1. 
2. 
3. 





1. Agjencia statistikore e Kosovës & Ministria e Diasporës

Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme		3.185.49	0.48	1529.0362
2	Sipërfaqet e parkingjeve dhe shtigjeve të këmbësorëve	m2	999.8	0.05	49.99
Total pozicioni 1+2					1579.0252

2. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme		250	1	250
2	Sipërfaqet e garazheve, arkivave dhe depoz	m2	60	0.05	3
Total pozicioni 1					253

3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Shqiptar

Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme	m2	30.818.00	0.42	12943.56
Total pozicioni 1					12943.56

4. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme		5.000.00	0.44	2200
2	Sipërfaqet e parkingjeve dhe shtigjeve të këmbësorëve	m2	150	0.05	7.5
Total pozicioni 1+2					2207.5

GRAND TOTAL – LOT 1

1. *[Signature]*
2. *[Signature]*
3. *[Signature]*

[Signature]

Nr.	Shërbimet e pastrimit	Çmimi total për muaj në €
1	Agjencia statistikore e Kosovës & Ministria e Diasporës	1579.0252
2		
3	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	253
4	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Shoqërore	12943.56
	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	2207.5
GRAND TOTAL – LOT 1		16983.0852

Lot 2 – Shërbime të pastrimit - Ndërtesa e Arkives së Kosovës, Agjencionit Kadastral, AKPM, IGJK, KPMM dhe MTI

1. Arkivi Shtetëror i Kosovës & Agjencioni Kadastral					
Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme	m2	5,852.33	0.5	2926.165
2	Sipërfaqet e parkingjeve dhe shtigjeve të këmbësorëve	m2	1,596.49	0.05	79.8245
3	Sipërfaqet e gjeibëruese	m2	5,718.56	0.05	285.928
Total pozicioni 1+2+3					3291.9175

2. Agjencia kosovare për produkte mjekësore					
Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €
1	Sipërfaqet e hapësirave të brendshme	m2	1,514.75	0.5	757.375
2	Sipërfaqet e parkingjeve dhe shtigjeve të këmbësorëve	m2	3,228.42	0.05	161.421
3	Sipërfaqet e gjeibëruese	m2	894.67	0.05	44.7335
Total pozicioni 1+2+3					963.5295

3. Instituti Gjyqësor i Kosovës					
Nr.	Shërbimet e pastrimit	Njësia	Sipërfaqet e hapësirave	Çmimi për m2	Çmimi total për muaj në €



1. [Signature]
2. [Signature]
3. [Signature]

[Signature]

Kriteret Dhënies	e	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet.
Ankesat		31.3	Agjencia Qendrore Prokurimit Rr. Nëna Terezë, Ndërtesa e Gërmisë , kati 5 Prishtine 10000

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PARATHENIE

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, është përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese; Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, pas aprovimit nga MF kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese ndihmon në kryerjen e aktivitetëve të prokurimit.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ– Nr. 02/2015 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, miratuar në mbledhjen e 13 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.02/13 me datë 12.02.2015, AQP është autorizuar që të fillojë me procedurat qendrore për Shërbime të pastrimit në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese Aneksin nr. 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar Ofruesit e Shërbimeve që do të kenë kapacitetin për të ofruar Shërbimet e pastrimit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuara në Aneksin 7.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës do të shpërndajë nga një kopje të nënshkruar të kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7. Një kopje e kontratës së nënshkruar do të publikohet në webfaqen e AQP-se.

Disa Autoritete Kontraktuese të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë kontratat e tyre ekzistuese. Këto kontrata nuk do të ndërpriten, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy javë para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftojë me shkrim AQP-në dhe Ofruesin e Shërbimeve lidhur me datën e skadimit të kontratës dhe datën e fillimit të shfrytëzimit të kontratës kornizë.

Ofruesi i Shërbimeve do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e ofruesit të shërbimeve për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar në Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë fokale ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

SQARIME PËR TERMET E PËRDORURA

1. Me termin "Mirëmbajtja Higjienike e Ndërtesave Qeveritare" nënkuptohet realizimi i të gjitha punëve të nevojshme lidhur me pastrimet – mirëmbajtjen e higjienës në ndërtesat Qeveritare në mënyrë që të përmbushen kërkesat për zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen në punë me të cilat duhet krijuar kushtet normale për punë të shfrytëzuesve të hapësirave në kuadër të ndërtesës Qeveritare

Mirëmbajtja higjienike përfshinë realizimin e punëve për:

- a. Mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha hapësirat e ndërtesës,
 - b. Mirëmbajtjen e shtigjeve të këmbësorëve si dhe të parkingjeve të automjeteve,
 - c. Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara
 - d. Largimin e mbeturinave – nga ndërtesa gjere te kontejnerët qendrorë për mbeturina
 - e. Bajtjet e materialeve, inventarit etj brenda në ndërtesa si dhe bajtjet në mes të ndërtesave qeveritare
2. Termi "Ndërtesa Qeveritare" në të cilat titullar është Qeveria apo i shfrytëzon Qeveria paraqet kompleksin i cili përbëhet prej:
 - ndërtesës apo kompleksit të objekteve në një hapësirë të kufizuar, (ndërtesat me të gjitha hapësirat
 - kthinat, nga bodrumet gjer në kulmet, komunikimin horizontal dhe vertikal,
 - komunikimin emergjent duke përfshirë fasadat e jashtme dhe parterin)
 - objekteve ndihmëse: kontejnerët, pikat e sigurimit.....etj
 - shtigjet e këmbësorëve,
 - parkingjet,
 - hapësirat e gjelbëruara
 - rrethojat dhe portat (normale, lura, rrëshqitëse ... etj)

ORARI I PUNES

Orari i rregullt i punës është prej orës (8.00 – 16.00) për çdo ditë pune (E Hënë – E Premte), ky orar mund të ndryshohet me vendim të institucioneve vendimmarrëse. Orari i paraqitur nuk do të vlejë kurdo që të ketë nevojë për të kryer ndonjë punë e cila nuk ka përfunduar gjatë orarit të rregullt të punës.

UNIVERZITETI PUBLIK I PRIZRENIT është e hapur për gjashtë deri në shtatë (6-7) ditë në javë, me trembëdhjetë (13) orë të punës për një ditë (përfshirë edhe një (1) orë pushim për drekë). Për ngjarje të veçanta, Ofruesi i Shërbimeve duhet të sigurojë shërbim të kontraktuarë edhe gjatë vikendeve përfshirë këtu edhe të dielën.

DETYRAT E MIRËMBAJTJES HIGJENIKE

Kërkohej që pastrimi të organizohet asistojë që hapësirat e përbashkëta (korridoret, shkallët, tualetet, hapësirat e gjelbëruara, parkingjet, shtigjet e këmbësorëve, rrugët, pllato etj) të pastrohen para orës 8.00 të mëngjesit ndërsa pas orës 8.00 të bëhet pastrimi i zyrave, sallave, etj

Pastruesja/si Kryen shërbimet e mirëmbajtjes së pastrimit - pastrimin e zyrave, orendive, korridoreve, shkalleve, dyshemeve, tualeteve, hapësirave tjera të jashtme dhe të brendshme të ndërtesave, fasadave, etj.

Pastrimi Fillestar Pa marrë parasysh shpeshtësinë – nivelin e pastrimit, ofruesi i shërbimeve duhet të kryejë të gjitha detyrat e pastrimit fillestar të përshkruar në listën e shërbimeve të pastrimit në afat prej (15) ditëve të para të kontratës që të sigurojë një pastërti standarde të llogaritur që nga fillimi. Pas këtij (pastrimit fillestar – pastrimi gjeneral), ofruesi i shërbimeve duhet të vazhdoj me shërbimet e pastrimit. Pastrimi fillestar nuk paguhet posaçërisht.

Detyrat ditore Ofruesi i shërbimeve është përgjegjës që të përkujdeset që këto hapësira të jenë të pastra në çdo kohë sipas standardeve të mëposhtme. Është përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve që të përkujdeset që këto standarde të mirëmbahen duke aplikuar intervalin e pastrimit sipas nevojës gjatë ditës për të mirëmbajtur një shërbim pa kurrfarë lëshimesh, prandaj varësisht nga angazhimet e pastrueseve ofruesi i shërbimeve cakton numrin e mjaftueshëm të pastrueseve.

Pastrimi i Dyshemesë Pas kryerjes së pastrimit të dyshemesë, dyshemeja duhet të lihet në gjendjen të pastër pa njolla dhe sipas nevojës në gjendje të thatë varësisht nga lloji i dyshemesë. Pastrimi duhet të kryhet në tërë sipërfaqen përfshirë qoshet, hapësirat mbrapa dyerve dhe përfundim mobilie dhe pajisjeve e tjera. Mobilet dhe pajisjet duhet të zhvendosen gjatë procesit të pastrimit dhe të kthehet në vendin e vet fillestar kur të kryhet pastrimi. Karriget asnjëherë nuk duhet të vendosen në tavolina ose tryeza. Pastrimi i tepihëve dhe dyshemeve duhet të kryhet në atë mënyrë, që tepihët dhe dyshemeja pas pastrimit të mos rrëshqas dhe mos të humbin ngjyrat. Të gjitha mbeturinat e pastruara duhet të vendosen në shporta të mbeturinave dhe të largohen jashtë objektit (të hidhen në kontejner). Shenjat paralajmëruese "sipërfaqja e lagësht" duhet të vendoset në vendet e dukshme në të gjitha katet dhe korridoret gjatë procesit të pastrimit me ujë, dhe duhet të largohen sapo të thahen sipërfaqet.

Pastrimi i rastit Pastrimi në vend të pa pastër (rastit) duhet të definohet si të kryhet puna largimi me dorë i ndonjë gjëje, pastrim i thjeshtë, fshirja me leckë të lagur ose pastrimi me fshesë elektrike të hapësirave të vogla, të cilat janë të lagura, derdhjet e ndryshme, njollat ose mbeturinat. Pastrimi në vend përfshin largimin e ujit, papastërtisë, rërës, njoillave të shkaktuara nga hapjet e dyerve në vendet me qarkullim të madh.

Fshirja Fshirja duhet të kryhet me anë të fshesave, brushave, leckave të pluhurit dhe fshesave elektrike pa zhurmë. Dyshemeja do të konsiderohet e pastër kur nuk është e lagur, nuk ka mbeturina, pluhur të dukshëm, grimca dhe mbeturinat të ushqimit e të tjera.

Pastrimi me fshesë elektrike Pastrimi me fshesë elektrike kryhet me fshesën elektrike pa zhurmë për tepihë, në fshesë duhet të vendoset thithësja në formë brusheje. Tepihu konsiderohet i pastruar kur nuk ka njolla, mbeturina dhe copëza dheu dhe copëza të tjera.

Fshirja me leckë të njomë Fshirja me leckë nevojitet për të pastruar hapësirat e dyshemesë së drurit kur pastrimi i lagësht nuk është i dëshirueshëm. Pas fshirjes, pastrimi i njomë mund të arrihet duke

shfrytëzuar leckën e lagur në tretje detergjenti/dezinfektuesi dhe shtrydhja e saj deri sa të jetë e lagur. Dyshemeja e pastruar mirë me leckë është ajo që nuk ka pluhur, njolla, cipë të hollë pluhuri, vija të dukshme të ndryshme, mbeturina dhe ujë të mbetur.

Pastrimi me leckë plotësisht të lagur Pastrimi me leckë plotësisht të lagur bëhet pas fshirjes së dyshemesë dhe në hapësirat ku nuk janë të vendosura tepihët – në dyshemetë gjysmë të nxehta dhe të ftohtë duke shfrytëzuar leckë pambuku ose shpuzë. Leckat duhet të zhyten më shpesh në ujë të pastër dhe tretje detergjenti dhe dezinfektuesi për të larguar papastërtirat. Dyshemetë pastaj shpërlahen me leckë të njomë për të larguar të mbeturat e pastrimit të lagësht dhe ujin e tepërt.

Hudhja dhe pastrimi i mbeturinave Kontejnerët – shportat e mbeturinave janë ato që shfrytëzohen për të hedhur mbeturinat e zyrës, dhe mbeturinat tjera. Kontejnerët e mbeturinave duhet të zbrazen dhe të lahen me shpuzë ose leckë të zhytur në tretje detergjenti. Kontejnerët e fshirë nuk duhet të përmbajnë pluhur, papastërti, njolla ose mbeturina. Kontejnerët e mbeturinave duhet të kanë mundësinë e vendosjes së qeseve plastike të cilat pastaj hidhen në kontejner të mëdhenj dhe së fundi në kontejnerët gjegjësisht në hapësirat e jashtme të ndërtesave ku grumbullohen mbeturinat nga i tërë objekti dhe pastaj largohet sipas procedurave të posaçme. Të gjitha llojet e shportave-kontejner për hedhjen e mbeturinave i siguron punëdhënësi.

Kthinat e banjove dhe tualeteve Pastrimi i urinareve, lavamanëve, tushave, mureve, dyerve, dhe të gjitha hapësirave tjera të lavatoreve bëhet me leckë, shpuzë, leckë të lagura, brusha dhe pajisje të tjera të cilat nuk përdoren më për asgjë tjetër vetëm për banjo dhe tualete. Detergjentet duhet të jenë dezinfektuese dhe me arome të këndshme e jo helmuese për shëndetin e stafit punës. Kthinat e banjës dhe e tualeteve janë të lara mirë kur edhe hapësirat nën vendosjen e instalimeve të sanitarisë dhe të tjera, gjithashtu edhe të gjitha hapësirat e dukshme janë të pastruara. Të gjitha instalimet duhet të kenë pamje të pastër – shkëlqim pa vija dhe njolla me pamje higjienike. Pastruesit- et duhet gjithmonë të punojnë me dorëza mbrojtëse.

Lustrimi i metalit Lustrimi i metalit kryhet pas fshirjes së lagësht dhe kryhet duke shfrytëzuar një leckë të butë bashkë me injektin përkatës për lustrim. Sipërfaqja e lustruar mirë është ajo ku nuk ka hapësira të nxira dhe mbeturinat e polirit dhe që ka shkëlqim të njëzuar në çdo pjesë.

Pastrimi i mureve dhe i dyerve Pastrimi i mureve përfshin muret, shtyllat, ndarjet, dekorimet, radiatorët, tabelat, zbkurimet e ndryshme dhe instalimet në mure. Pastrimi i derës përfshinë dyert, anën (faqet) e dyerve dhe orënditë ose dekorimet në dyer. Pastrimi bëhet me anë të shpuzës së njomë ose leckës së zhytur në tretjen e detergjentit dhe dezinfektuesit. Sipërfaqet e pastruara mirë duhet të jenë të shndritshme, të mos kenë papastërti mykë njolla, hapësira të nxira, ose të stërpikura. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet largimit njollave dhe pikave të yndyrshme në hapësirat me qarkullim të madh dhe atje ku dyert shfrytëzohen shumë shpesh. Dera e pastruar mirë nuk duhet të ketë vija ose vende të pa pastërta.

Pastrimi i xhamave dhe pasqyrave Xhamat dhe pasqyrat duhet të pastrohen me leckë dhe/ose me shpuzë të lagur në detergjent ose pastrues të xhamit. Kjo duhet ta pasohet nga polirimi (lustrimi) duke përdorur leckë të thara ose peshqir prej letrë. Buzët dhe kornizat ngjitës po ashtu duhet të pastrohen dhe të lustrohen. Sipërfaqe qelqi e pastruar mirë është ajo e cila nuk ka pluhur, pa pastërti, vaj, pika, vija, ose mbeturina. Gjatë pastrimit dimëror të gjitha shenjat e vijave, papastërtisë, pikave të ujit dhe materieve të tjera të huaja duhet të largohen nga kornizat, parvazet dhe qelqi me anë të pastruesit adekuat të xhamave. Dritaret e jashtme nuk përfshihen në këtë kërkesë.

Pastrimi i dritave Pastrimi i dritave, poqave, armaturave, përfshin largimin e mbulesave të dritave dhe fshirjen brenda dhe jashtë të çdo mbulueseje duke përdorur një leckë të lagur. Instalimet flouroscente, përfshirë tubat (e neonit) dhe zbutësit e shndritjes, duhet të pastrohen lehtë dhe pluhuri ose njollat t'iu fshihen. Drita e pastruar mirë nuk duhet të përmbajë insekte, papastërti, pluhur dhe materiet tjera të jashtme.

Larja e tepihëve me shampun dhe pastrimi i tapicerive Larja e tepihut me shapon është proces i vendosjes së stamponit për tretje higjienike të fijeve të tepihut dhe shfrytëzimi i makinës ekstraktuese për larjen e tepihut. Tepihu i larë mirë me shampun është ai që është pastruar në mënyrë të njëtrajtshme sipas udhëzimeve të prodhuesit të shampunit të përdorur.

Punët dhe Pastrimet e posaçme Menaxheri i kontratës nga ana e punëdhënësit, ose përfaqësuesi i tij/saj i autorizuar mund t'i kërkoj ofruesi i shërbimeve të kryej shërbime në ndërtesë para ose pas vendosjes së personelit. Këto kërkesa aplikohen varësisht nga gjendja e pajisjeve, sistemeve, pastrimit në ndërtesa si dhe në bazë të kërkesave nga ndërtesat. Këto shërbime kryhen nga ofruesi i shërbimeve pa kompensime financiare shtesë. Shërbimet përfshijnë punët si në vijim:

Hapësirat me tepih: larja me shampun me metodën e shkumës së tretur dhe largimi i njollave me kimikale adekuatë nga dyshemetë dhe muret

Xhamat/dritaret: pastrimi special i pasqyrave/xhamave/qelqit për të larguar njolla dhe shenja.

Dyshemeja: Larja mekanike e dyshemesë, vendosja e dyllit, lustrimi me materiale speciale për largimin e njollave të ushqimit dhe shenjave tjera.

Mobiliet: Pastrimi special dhe lustrimi i mobilieve me tapiceri.

Guacat: Largimi i acideve urinore dhe njollave gëlqerore.

Shërbimet e kopshtarisë dhe ato të përgjithshme përfshijnë:

Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta tërë kohën duke pasur në gjendje të pastër dhe të rregullt, dizajnimi i kopshteve me lule, duke përpunuar dheun, plehrosur si dhe duke ujitur sipas nevojës, prerjen e sipas nevojës së vegetacionit.

Mirëmbajtja e vendkalimeve, terrasave, pllatove dhe parkingjeve.

Njëherit mban rregullësin dhe gjendjen pa borë dhe akull, sipas nevojës dhe sipas kërkesës nga punëdhënësi krypos dhe hedhë rërë – krip (rërën dhe kripën e nevojshme e siguron ofruesi i shërbimeve)

Pastron nga gjethet dhe mbeturinat sistemet e drenazhimit, kanalizimit, olluqeve dhe gypat tjerë.

Mbeturinat e grumbulluara nga ndërtesa hidhen tek kontejneri ose te vendi tjetër i përcaktuar për atë qëllim.

BARTJET

Ofruesi i shërbimeve kryen të gjitha bartjet e nevojshme brenda në vet ndërtesën qeveritar apo nga një ndërtesë në ndërtesën tjetër, pavarësisht a është personeli i të njëjtës Ministri apo të personelit të Ministrive tjera. Ofruesi i shërbimeve për realizimin e bartjeve të ndryshme siguron fuqinë punëtore të nevojshme edhe të gjitha mjetet e nevojshme për transportim duke përfshirë edhe mjetet transportuese nga njëra ndërtesë në ndërtesën tjetër.

Ofruesi i shërbimeve është i obliguar që të siguroj mjetet transportuese - kamionë për bartjen e inventarit dhe materialeve të ministrive prej një ndërtese në ndërtesën tjetër (bartjen e inventarit, fajlla të ndryshëm dhe materiale tjera shpenzuese e të tjera). Për këto shërbime duhet të siguroj kamion me mbulesë. Kamioni duhet të ketë volumn e nevojshëm sipas kërkesë për bartje që do të bëhet nga AK-se. Nëse bartja do të organizohet prej një ndërtese (ndërtesë që e mirëmban njëra kompani) në ndërtesën tjetër (ndërtesa të cilën e mirëmban kompania tjetër) pra kemi rastin ku janë të kyçura dy kompani të ndryshme në realizimin e bartjes, në këtë rast bartja do të realizohet asistojë që :

- kompania e cila e mirëmban ndërtesën prej ku do të bëhet bartja duhet të siguroj fuqinë punëtore, kamionin pajisjet dhe veglat tjera të nevojshme për realizimin e transportit, të bëjë ngarkimin e gjësendeve në kamion, të transportoj të njëjtat gjer në ndërtesën ku duhet të vendoset personeli dhe pajisjet e bartura të shkarkoj nga kamioni,
- kompania e cila mirëmban ndërtesën ku duhet të vendosen personeli dhe pajisjet e bartura do të pranojnë materialin dhe gjësendet e bartura dhe do t'i bart brenda në ndërtesë dhe do t'i vendos nëpër zyre – hapësira të caktuara sipas planit të përgatitur paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues.

Për realizimin e bartjeve të kërkuara Ofruesi i shërbimeve angazhon fuqinë punëtore, veglat, mjetet, dhe mekanizimin (automjete, kamiona, kamion me mbulesë, pirunor, vinqa etj) që të gjitha sipas nevojës gjegjësisht materialit që do të transporton, për të gjitha llojet e transporteve që do t'i realizon Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë pagesa shtesë pra këto punë duhet llogaritur dhe përfshirë në çmimin mujor të mirëmbajtjes

PERIUDHAT E PASTRIMIT

Kodet e intervaleve	periudha e realizimit
D	Çdo ditë
D-SN	Çdo ditë dhe sipas nevojës
2D	Dy herë në ditë
J	Një herë në javë
M	Një herë në muaj
M2	Çdo dy muaj
M3	Çdo tre muaj
M6	Çdo gjashtë muaj
SN	Sipas nevojës

PLANI DINAMIK THEMELOR PËR KRYERJEN E MIREMBAJTJES HIGJENIKE

Tualetet dhe banjot periudhat e realizimit

- Fshirja e dysHEMEVE D-SN
- Fshirja e dysHEMEVE me ujë të ngrohtë dhe dezinfektues D-SN
- Larja dhe dezinfektimi i tualeteve, dusheve dhe lavamanëve D-SN
- Larja dhe gryerja me ujë të ngrohtë dhe sapun dezinfektimi i të gjitha urinareve, vendosja e tabletave dezinfektues dhe plastikeve-gomave të shpuara D-SN
- Larja dhe terja e pasqyrave D-SN
- Zbrazja e shportave për letra D-SN
- Lustrimi i çesmeve të ujit dhe të gjitha instalimeve D-SN
- Pastrimi i mureve, dyerve, dritareve, elementeve tjera D-SN
- Largimi i pluhurit nga poçat elektrik, trupat nxehës, pllafoneve J
- Vendosja e peshqirëve të letrës, letër tualetit, sapunëve, dhe dezodoranteve të urinareve D-SN

Korridoret shkallët dhe hyrjet

- Pastrimi i tepihëve me fshesë elektrike pa zhurmë D
- Fshirja e korridoreve dhe pastrimi i tyre me leckë të njomë D-SN
- Pastrimi i sipërfaqeve me leckë të lagur (sipërfaqet e forta përveç atyre të drunjtë) D-SN
- Pastrimi i dysHEMEVE me leckë të njomë D
- Pastrimi i dyerve, dorëzave dhe tabakave të xhamit D
- Lustrimi i instalimeve nga metali J
- Fshirja e pluhurit nga pikturat, tabelat e shpalljeve, shenjave dhe mobilieve J
- Fshirja e pluhurit nga parvazet e dritareve, mureve, plafonëve gypave, tablove dhe dritave J
- Larja dhe terja e dritareve (brenda dhe jashtë) M2
- Larja e tepihëve me shampun M6-SN
- Pastrimi i mureve, dyerve dhe orendive nga druri M3
- Pastrimi i njollave në mure, dyerve dhe tepihëve D-SN

- Zbrazja e shportave të mbeturinave D-SN
- Hedhja e pakove, mbështjellëseve dhe mbeturinave tjera nga zyret D-SN

Zyret, klasat dhe sallat e konferencave

- Zbrazja dhe pastrimi i shportave të letrave dhe shpuzoreve D-SN
- Fshirja dhe pastrimi i dysHEMEVE me leckë D-SN
- Pastrimi i dysHEMEVE me leckë të lagur D
- Pastrimi i dysHEMEVE të drurit me leckë të njomë D
- Pastrimi i tepihëve me fshesë elektrike, fshesë elektrike pa zhurmë D
- Pastrimi i pluhurit në të gjitha mobilet, parvazet e dritareve, pajisjet/makinat për zyre dhe ngrohësit J
- Pastrimi dhe dezinfektimi i telefonave, kompjuterëve dhe pajisjeve tjera J
- Pastrimi nga pluhuri i dritareve, mureve, orendive nga druri, plafonëve, trupave ndriçues, tabllave, dyerve, dritareve J
- Larja dhe terja e dritareve (të brendshme dhe të jashtme) M2
- Larja e tepihëve me shampoon M6-SN
- Larja e mureve, dyerve dhe orendive nga druri SN
- Larja e mobilieve SN
- Pastrimi i njollave nga tapiceria e mobilieve SN
- Pastrimi i njollave nga të gjitha muret dhe orenditë e drurit SN
- Pastrimi i njollave në tepihë SN

Dhomat e furnizimit dhe depot

- Zbrazja dhe pastrimi i shportave të letrave dhe shpuzoreve D-SN
- Fshirja dhe pastrimi i dysHEMEVE me leckë D-SN
- Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë D
- Të fshihet dhe të pastrohet me leckë dysHEMEJA J
- Pastrimi i pluhurit në të gjitha mobilet, tablove dhe dritave J
- Pastrimi sipas nevojës në të gjitha muret dhe orenditë e drurit SN

Hapësirat e punëtorive dhe hapësirat teknike (Këto hapësira duhet pastruar në bashkëpunim dhe nën mbikëqyrjen e personelit profesional teknik jo vetëm pastrues i /ja)

- Fshirja dhe pastrimi i pluhurit me leckë në dysHEME J
- Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë D
- Fshirja e pluhurit nga pajisjet, mobilet, tablove dhe dritave J
- Pastrimit sipas nevojës i mureve dhe dyerve, dritareve SN

Hapësirat e pllatoeve, shkallëve të jashtme, parkingjeve, trotuareve, drenazhave

- Fshirja dhe pastrimi i pluhurit dhe mbeturinave të ndryshme D- SN
- Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë D- SN
- Shenjëzimi i vend parkimeve , pastrimi dhe largimi i mbeturinave dhe gjelbërimeve SN

Hapësirat e gjelbruara

- Fshirja dhe pastrimi nga mbeturinat, gjethet dhe frytet e drunjtëve D-SN
- Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë të gjelbëruar D
- Rregullimi, ujitja, dizajnimi i luleve në hapësira të gjelbëruara dhe saksia J-SN

Fasadat, terasat, kulmet

- Fshirja dhe pastrimi nga mbeturinat, gjethet dhe frytet e drunjtëve si dhe papastëritat e ndryshme SN
- Të mos ketë mbeturina në asnjë hapësirë

Pastrimi i mureve, dritareve, xhamave dhe pjesëve tjera të fasadave dritaret, xhamat dhe pjesët e fasadës, pjesa e jashtme duhet pastruar duke shfrytëzuar mekanizimin – vinçin apo ashensorin e posaçëm për pastrim të fasadave për ndërtesat e larta së paku çdo (6) muaj dhe sipas nevojës edhe më shpesh varësisht nga gjendja dhe moti i cili dikton pastrimin dhe kërkesën nga DSPIMN.

MATERIALI PËR MIREMBAJTJE HIGJENIKE

Materialin harxhues për realizimin e mirëmbajtjes higjienike duhet ta siguroj vetë kompania.

I tërë materiali duhet të jetë i kualitetit të lartë dhe klasit të parë.

Ofruesi i shërbimeve, para se të fillojë aplikimin e materialit, duhet sjellur mostrat për aprovim me shkrim nga AK.

Pa aprovimin e materialit nga AK, nuk lejohet përdorimi i të njëjtit për mirëmbajtje higjienike.

Minimumi i materialeve të nevojshme për pastrim të cilat Ofruesi i shërbimeve duhet siguruar pandërprerë dhe në sasi të nevojshme dhe mjaftueshme pavarësisht nga shpenzimi – harxhimi i tyre janë:

- Letër tualeti, dy-shtesore e bardhë e kualitetit të lartë
- Letër për duar e trashë, e bardhë, e gjerë (dyfishi i tualet letrës) e kualitetit të lartë, varësisht nga mekanizmat e instaluar për mbajtjen e letrës,
- Sapun të lëngshëm
- Dezodorant për urinare, tableta dezinfektuese, plastika – goma të shpuara
- Sapun dezodorant (përfshirë edhe shportën) për guaca
- Dezinfektues të tualeteve
- Dorëza plastike për pastruesit
- Detergjent për pastrimin e dritareve
- Detergjent për pastrimin e dyshemesë
- Detergjent për pastrimin e tepihëve
- Qeska për të gjitha llojet e kontejnerëve - shportave të mbeturinave
- Qeska për shportat e letrave
- Dezodorans për kabinete, zyre, salla ,
- Detergjent për pastrimin e Pllakave
- Kovë për pastrimin e dyshemesë
- Makina për pastrim dhe lustrim të pllakave të mermerit - granitit
- Fshesë elektrike pa zhurmë me pjesët përbërëse
- Kripë për shkrirjen e borës , akullit,
- Kripë me rërë për shkrirjen e borës, akullit,
- Fshesa për kopsht
- Brusha të ndryshme për pastrime të tualeteve,
- Vegla të ndryshme për punët e gjelbërimit, lulet, ,rrethojat e gjalla, bari, etj
- Lecka për pastrimin e dyshemesë
- Sfungjerë (shpuzë)
- Lecka për pastrimin e dritareve dhe mobilie
- Polir (shkëlqyes) për mobile
- Polir (shkëlqyes) për metal dhe mesing
- Lecka për pastrimin e dritareve
- Polir për dysheme
- Detergjent për qeramike
- Detergjent për heqjen e njollave
- Brusha për çpluhërosje (pastrimin e pluhurit) etj
- kocka dezinfektuese për urinare etj

- Pajisje dhe makineri për pastrimin dhe sipas nevojë larjen e fasadës me të gjitha pjesët përbërëse të saja si dritareve dhe elementeve tjera të pjesës së jashtme dhe brendshme të fasadës

Kushte te vecanta

Punëdhënësi mban të drejtën që për cilindo ndërtesë të paraqes kërkesën për ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes edhe para se të skadojë kontrata për arsyt të cilat mundën me u paraqitur për shkak të krijimit të situatave të ndryshme si p.sh për riakomodime, lirim i ndërtesës, renovim i ndërtesës e të ngjashme. Pas marrjes me shkrim të shkresës për ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve për ndërtesa të caktuara ofruesi i shërbimeve duhet ndaluar ofrimin e shërbimeve meqenëse nga data e cekur në shkresën informuese nga mbikëqyrësi, nuk do të bëhet pagesa për shërbimet e mirëmbajtjes

Gjersa të mos merret kërkesa nga mbikëqyrësi i AK të specifikuar ane Aneksin 7 për fillimin e inicimit të punëve, punëdhënësi nuk ka obligime për pagesë ndaj Ofruesi i shërbimeve edhe pse e ka kontratën e nënshkruar.

AK janë të specifikuara në Aneks 7. AK rezervon të drejtën që gjatë implementimit të kontratës, në rast se një AK-es zhvendoset në një objekt tjetër, të kërkojë nga ofruesi i Shërbimeve që të vazhdojë punën në objektin e ri. Kjo kërkesë është obligative për Ofruesin e shërbimeve. Hapësira e sipërfaqes së objektit të ri do të llogaritet në bazë të çmimit njësi të ofertuar nga Operatori Ekonomik.

Gjatë zbatimit të kontratës, me arsyetim të duhur, Menaxheri mbikëqyrës i AK mund të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve rritjen e numrit të punëtorëve, largim të punëtorit të caktuar, shtimin e veglave dhe mjeteve të ngjashme. Pas marrjes së kërkesës me shkrim Ofruesi i shërbimeve obligohet që të realizoj kërkesën në afat prej pesë (5) ditë kalendarik pa kërkuar kompensim shtesë për asnjë rast. Nëse Ofruesi i shërbimeve nuk e realizon kërkesën e pranuar, punëdhënësi merr masa ndëshkuese me dënime si dhe në rastin më të rëndë edhe me kërkesën për shpërblyerje të njëanshme të kontratës.

Ofruesi i shërbimeve tërë kohën duhet të ketë punëtorë të mjaftuar pavarësisht nga obligimet e tij ndaj punëtorëve të tij (Pushime vjetore, pushimet mjekësore,etj).

Ofruesi i shërbimeve për çdo javë do të dorëzojë listën e kërkesave të realizuara dhe specifikimin e materialit të shpenzuar për realizimin e këtyre kërkesave.

Ofruesi i shërbimeve duhet mbajtur historikun për punët e kryera në sisteme dhe hapësira për secilën ndërtesë dhe lami në veçanti, duke u bazuar në punët e kryera sipas kërkesave, planeve, ditarit të punës dhe ditarin e kujdestarisë.

Ofruesi i shërbimeve obligohet që dy deri tri ditë para se të fillojë muaji i ri, përmes shkresës zyrtare të dorëzojë listën e punëtorëve të cilët do të angazhohen për kryerjen e punëve për muajin i cili pason.

Siguria në punë - Ofruesi i shërbimeve është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke:

- bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt
- duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve
- duke u siguruar në përdorimin e drejtë të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët,
- duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si: rroba pune, helmata, këpucë adekuate varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse, dorëza pune ...etj
- varësisht nga natyra e punës të angazhojë punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme

OBLIGIMET E PUNËDHËNSIT NDAJ OFRUESIT TE SHËRBIMEVE JANË:

- të siguroj hapësira për ekipet e punëtorëve të Ofruesi i shërbimeve në kuadër të ndërtesave
- duke bashkëpunuar dhe udhëzuar sipas nevojë punëtorët e Ofruesi i shërbimeve, të ndikojë në krijimin e kushteve normale të punës
- të sigurojë kartelet identifikuese për qasje në ndërtesa sipas kërkesës dhe listës së punëtorëve të drejtuar nga drejtori i Ofruesit të shërbimeve
- të bëjë procedimin e faturave mujore për pagesë sipas procedurave dhe obligimeve ligjore

Pagesat

Secili AK i specifikuar në Aneksin 7 do të bëjë pagesat për shërbimet e kryera në objektet e tyre. Ndërsa MAP do të menaxhon dhe do të bëjë pagesën për këto Autoritete Kontraktuese:

Nr.	Autoriteti Kontraktues
1.	Agjencia statistikore e Kosovës
2.	Ministria e Diasporës
3.	Arkivi Shtetëror i Kosovës
4.	Agjencioni Kadastral i Kosovës
5.	Agjencia kosovare për produkte mjekësore
6.	Ministria e Administratës Publike
7.	Ministria e Drejtësisë
8.	Ministria e Pushtetit Lokal
9.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
10.	Agjencia për Administrimin e Aseteve të sekuestruara dhe të Konfiskuara
11.	Ministria e Infrastrukturës
12.	AQP
13.	KRPP
14.	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
15.	Ministria e Arsimit me institucionet vartëse të saj
16.	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
17.	Ministria e Bujqësisë
18.	Ministria e Kulturës Rinise dhe sporteve
19.	Zyra e Kryeministrit
20.	Ministria e Financave
21.	Ministria e Integritetit
22.	Sekretariati i Këshillit të Sigurimit të Kosovës
23.	MFSK-ja
24.	Ministria e Punëve të Jashtme
25.	Agjencioni Shtetëror për Mbrojtje të Dhënave personale
26.	Institucionet gjyqësore

OBLIGIMET SHITESË TË OFRUESIT TE SHËRBIMEVE:

Paga bruto mujore për një punëtor (pastruese) nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 200 € për një muaj. Në rast se gjatë implementimit të kontratës, Qeveria e Kosovës nxjerr një vendim për pagat minimale të punëtorëve të sektorit privat, OE merr përsipër që të rrisë pagën mujore në përputhje me vendimin. Në këtë rast nuk do të ketë ndryshim të cmimit të ofertuar më pas OE do të jetë i obliguar që të zbatojë vendimin e Qeverisë. Nga operatori ekonomik kërkohet që të dorëzojë një deklaratë origjinale të

vulosur dhe të nënshkruar se do të respektojë pagën bruto mujore për një punëtor (pastruese). Deklarata dorezohet para nënshkrimit të kontratës. Po ashtu kërkohet të respektohet Ligji i punës dhe rregullat e aplikushme lidhur me orët e punës për një muaj.

Ne rast se AQP pranon oferta me çmime të njëjta kriteri i cili do të aplikohet në mes të dy OE me çmime të njëjta është – “Short në mes të atyre OE”.

Lënda e Kontratës është e ndarë në 11 lote

Lot 1 – Shërbime të pastrimit – Ndërtesa e Agjencisë Statistike të Kosovës, Ministria e Diasporës, ARH, MPMS dhe SKGJK

Autoriteti kontraktues	Sipërfaqet hapësirave brendshme	Sipërfaqet parkingjeve dhe shtigjeve këmbësorëve	Sipërfaqet e gjelbëruara	Sipërfaqet e garazheve, arkivave dhe depos
Agjencia statistikore e Kosovës	3,185.49	999.8		
Ministria e Diasporës				
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	250.00			60.00
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Shogëror	30,818.00			
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	5,000.00	150.00		

- Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale – Objektet e MPMS shtrihen në me se vijon:

nr.1	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Prishtinë	
1.	QRP Prishtinë	800.00
2.	ZKP Fushë Kosovë	70.00
3.	ZKP Obiliq/Kastriot	308.00
4.	ZKP Podujevë/Besianë	300.00
5.	ZKP Lipjan	153.00
6.	ZKP Novobërdë / Artanë	220.00
7.	ZKP Gllgovc / Drenas	190.00
8.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Prishtinë	896.70
9.	Divizioni I Komisioneve mjeksore (TMK)	300.00
10.	Aip – zyra të qafa , Prishtinë dhe Graçanice	170.00
11.	Aip - qendra	200.00
12.	Aip – Besian Zyra në komunë	20.00
13.	Aip – Kastriot Zyra në higjienateknik	35.00
14.	Aip - Lipjan Zyra në komunë	25.00
15.	Aip – Shtimje-zyra në komunë	30.00
16.	DMS - të Qafa	464.00
17.	Apk Prishtinë (Barnat)	366.00
18.	Aip-zyra në drenas	12.00
19.	DSHQA	2,050.00
20.	DFDIL	530.00
21.	Zyra e IPS	215.00
22.	ISSH	1,494.73

23.	Shtëpia e pleqve	2,940.00
24.	ZKP Graçanicë	50.00

nr.2	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Prizrenit	
1.	QRP Prizren	660.00
2.	ZKP Dragash/Sharr	380.72
3.	ZKP Suharekë / Therandë	220.00
4.	ZKP Rahovec	149.00
5.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Prizren	865.25
6.	Administrata Pensionale e Kosovës Prizren	1,440.00
7.	Aip – zyra ne qrp Prizren	70.00
8.	Aip-zyra ne – komunë - Rahovec	28.00
9.	Aip-zyra ne qrp - Malishevë	16.00
10.	Aip-zyra ne komun - Sharr	16.00

nr.3	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Pejës	
1.	QRP Pejë	780.00
2.	ZKP Istog/Burim	280.00
3.	ZKP Klinë	196.00
4.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Pejë(&Fieze)	753.00
5.	Administrata Pensionale e Kosovës Pejë	503.00
6.	AIP- ZYRA NE QRP	50.00
7.	AIP-ZYRA NE KOMUN	70.00
8.	AIP-ZYRA NE QPS -DEQAN	60.00
9.	ZYRA RAJONALE E DFIDL NE PEJË	25.00

nr.4	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Gjakovë	
1.	QRP Gjakovë	582.00
2.	ZKP Deçan	260.00
3.	ZKP Malishevë	276.00
4.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Gjakovë	980.00
5.	Administrata Pensionale e Kosovës Gjakovë	540.00
6.	ZYRA RAJONALE DFIDL -GJAKOV	25.00
7.	AIP –ZYRA NE APK GJAKOV	48.00

nr.5	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Gjilan	
1.	QRP Gjilan	527.00
2.	ZKP Viti	235.16
3.	ZKP Kamenicë /Dardanë	251.40
4.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Gjilan	987.00
5.	Administrata Pensionale e Kosovës Gjilan	795.00
6.	Dfidl – zyra ne Gjilan	20.00
7.	Aip-zyra ne apk Gjilan	120.00
8.	Aip-zyra ne qrp -Dardan	12.00
9.	Aip-zyra ne gjeodezi -Viti	16.00
10.	ZKP Partesh	153.00
11.	ZKP Ranillug	220.00

nr.6	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
------	------------------	--

	Rajoni Ferizaj	
1.	QRP Ferizaj	1,034.88
2.	ZKP Kaçanik	73.90
3.	ZKP Shtime	327.60
4.	ZKP Shtërpce	18.00
5.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Ferizaj	834.40
6.	Administrata Pensionale e Kosovës Ferizaj	545.00
7.	Dfidi-zyra ne Ferizaj	16.00
8.	Aip-zyra ne komunë ne Ferizaj	20.00
9.	Aip –zyra ne komunë - Shtërpce	16.00
10.	Aip –zyra ne komunë - Kaçanikë	16.00

nr.7	Ndërtesa/Objekti	Totali i m ² sipas objekteve.
	Rajoni Mitrovicë	
1.	QPS Leposaviç	520.00
2.	QPS Zveçan	520.00
3.	QPS Zubin Potok	170.00
4.	QRP Mitrovicë	830.00
5.	ZKP Skenderaj	340.00
6.	ZKP Vushtri	250.00
7.	ZKP Leposaviq	45.00
8.	ZKP Zveçan	40.00
9.	ZKP Zubin Potok	
10.	Qendra e Aftësimeve Profesionale Mitrovicë	1,049.00
11.	Administrata Pensionale e Kosovës Mitrovicë	350.00
12.	Zyra rajonale e DFIDL ne Mitrovicë	50.00
13.	Aip –zyra ne apk Mitrovicë	40.00
14.	Aip-zyra ne komunë - Vushtri	22.00
15.	Aip-zyra ne komunë - Skenderaj	40.00

- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës – ish objekti i Gjykatës supreme si dhe zyra e Prokurorit Disiplinor e vendosur ne ish objektin e OSBE-se

Lot 2 – Shërbime të pastrimit - Ndërtesa e Arkives se Kosovës, Agjencionit Kadastral, AKPM, IGJK, KPMM dhe MTI

Autoriteti kontraktues	Sipërfaqet hapësirave brendshme e të	Sipërfaqet parkingjeve dhe shtigjeve këmbësorëve e të	Sipërfaqet e gjelbëruara	Sipërfaqet garazheve, arkivave dhe depos e
Arkivi Shtetëror i Kosovës	4,887.33	1,596.49	5,718.56	
Agjencia Kosovare për produkte mjekësore	1,514.75	3,228.42	894.67	
Arkivi Shtetëror i Kosovës	965.00			
Instituti Gjyqësor i Kosovës	1,224.84	1,102.00	39.00	
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1,250.00		70.00	
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	4,458.00	2,033.55	1,717.67	

- Arkivi Shtetëror i Kosovës – Përveç objektit që gjendet ne Prishtine objektet tjera janë:

Adresa	Sipërfaqet e hapësirave
--------	-------------------------



NDËRMARRJA TREGTARE SHERBYESE NDËRTIMORE
TRADEING SERVICES AND BUILDING ENTERPRISE

BENI

address: Brigada 123, Therandë
e-mail: bennitrade@hotmail.com

Tel: +377 44 184 203
+386 49 501 022

Pastrimi robërtyesh të lartësi 20 m

SHËRBIMET E PASTRIMIT

DEKLARATË

N.P.T. „BENI” me pronar : ARBEN KUÇI nga Suhareka deklaron:

Që nese do te jem ofertuesi fitues , do te respektojme pagen bruto mujore per nje punetore (pastruese) –paga bruto me se paku 200€,si dhe do te respektojme ligjin e punes dhe rregullat e aplikueshme lidhur me oret e punes per nje muaj , sipas kushteve te paraqitura ne dosjen e tenderit me titull:

“Sherbime te pastrimit”

Nr. i Prokurimit	AQP	15	010	211
------------------	-----	----	-----	-----


Data:

25.05.2016

N.P.T. „BENI”

Arben Kuçi

Suhareka





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company I.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **67187**

Për AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të NPT BENI

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim: Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Sherbime te pastrimit - Ritender Llot 1 - Ekzekutim i kontrates**
Nr. prokurimit: AQP-15-010-211, Nr. brendshëm: 00

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **53,500.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmimeve të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **53,500.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 24.06.2021 ora 12:29:35

Data lëshimit: 25.05.2018

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

